



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**

**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK DHE PËRMIRËSIMIT TË KLIMËS SË BIZNESIT**

**Specifikime teknike për objektin e prokurimit**

**Objekti i prokurimit:** Organizim i aktiviteteve promovuese të lidhura me festat ndërkombëtare.

**Shërbimi që kërkohet:**

Operatori duhet të marrë përsipër realizimin e aktivitetit “Organizim i aktiviteteve promovuese të lidhura me festat ndërkombëtare”, me qëllim promovimin e parimeve të Bashkimit Evropian në nivel vendor dhe informimin periodik të publikut. Gjatë vitit do të zhvillohen aktivitete të ndryshme për ditët evropiane dhe ndërkombëtare, duke përfshirë Shkollën Pranverore Evropiane, Ditën Botërore të Turizmit, Ditën e Tokës dhe Ditën Evropiane të gjuhëve të huaja, të cilat synojnë edukimin mbi vlerat e BE-së, mbrojtjen e mjedisit, promovimin e turizmit dhe rëndësinë e gjuhëve të huaja.

Për këtë arsye është i nevojshëm realizimi i shërbimit si më poshtë:

| <b>Nr.</b> | <b>Emërtimi</b>   |
|------------|---|
| <b>I</b>   | <b>Organizim i aktiviteteve promovuese të lidhura me festat ndërkombëtare</b> |
| <b>A</b>   | <b>Dita Evropiane e Gjuhës</b>  |
| 1          | Organizim aktiviteti (ledwall + foni + dj.)                                   |
| 2          | Set cadra + tav + karrige (20 sete)   |
| 3          | Dekorim aktiviteti  |
| 3          | Printim poster 20 copë për secilën shkollë pjesëmarrëse                       |
| 4          | Moderim aktiviteti  |
| <b>B</b>   | <b>Dita e Tokës dhe mbrojtjes së biodiversitetit</b>                          |

|          |   |
|----------|---|
| 3        | Transporti për të rinjtë vullnetarë në kuadër të Ditës së Tokës   |
| 4.       | Aktivitet sensibilizimi për pastrimin e zonave turistike që përfshin materiale të tilla si qese plehrash 70L, doreza llastiku |
| 9        | Puntori për mbjellje lule/fidanë  |
| <b>C</b> | <b>Shkolla Pranverore Evropiane</b>   |
| 4        | Transporti për të rinjtë gjatë Shkollës Pranverore Evropiane  |
| 5        | Materiale promocionale spila, rrip dore promocional   |
| 6        | Flamuj me mekanizëm me logon e Bashkisë Shkodër. Lartësia e flamurit pa mbajtëse 300 cm me gjerësi 75 cm                      |
| 7        | Specialistë të fushës dhe cështjeve të integritimit evropian (3 persona)  |
| 8        | Katering (40 persona x 4 ditë) gjatë Shkollës Pranverore Evropiane  |

## **SPECIFIKIMET TEKNIKE SIPAS ZËRAVE TË LARTPËRMENDUR**

### **I. Organizim i aktiviteteve promovuese të lidhura me festat ndërkombëtare**

#### **A. Dita Evropiane e Gjuhës**

1. Operatori ekonomik duhet të marrë përsipër organizimin teknik dhe logjistik të aktivitetit në kuadër të Ditës Evropiane të Gjuhëve, duke përfshirë sigurimin e pajisjeve dhe shërbimeve të nevojshme për mbarëvajtjen e tij. Në këtë kuadër, operatori duhet të sigurojë një LED Wall me përmasa 3 m x 2 m, të përshtatshëm për përdorim në ambiente të jashtme, i cili duhet të jetë plotësisht funksional për një kohëzgjatje prej të paktën 4 orësh. Shërbimi duhet të përfshijë transportin, instalimin, çmontimin, si dhe praninë e një operatori teknik gjatë gjithë zhvillimit të aktivitetit, duke garantuar funksionim pa ndërprerje dhe testim paraprak të pajisjes.
2. Operatori ekonomik duhet të sigurojë një sistem audio profesional të përshtatshëm për ambiente të hapura, i përbërë nga bokse zanore me fuqi të mjaftueshme, mixer audio, si dhe minimumi dy mikrofona (një me kabëll dhe një pa kabëll), së bashku me të gjithë aksesoret dhe kabllimet përkatëse. Gjithashtu, operatori duhet të sigurojë një DJ ose operator audio, i cili do të menaxhojë muzikën dhe sistemin e zërit gjatë gjithë aktivitetit, duke përdorur një përzgjedhje muzikore të përshtatshme me natyrën e aktivitetit.

3. Operatori ekonomik mban përgjegjësi të plotë për transportin, instalimin, funksionimin dhe çmontimin e të gjitha pajisjeve, si dhe për garantimin e kushteve të sigurisë teknike, përfshirë instalimet elektrike, duke siguruar zhvillimin e aktivitetit pa ndërprerje apo probleme teknike.
4. Operatori ekonomik duhet të sigurojë me qera dhe instalojë set cadrash (copë 20), për aktivitetin dedikuar Ditës Evropiane të Gjuhëve, ku çdo set duhet të përfshijë:
  - a) 1 çadër të përshtatshme për ambiente të jashtme;
  - b) 1 tavolinë;
  - c) 1 mbulesë tavoline;
  - d) Minimumi 2 karrige.
5. Çdo stendë do të përfaqësojë një shkollë pjesëmarrëse dhe do të ketë si fokus promovimin e gjuhëve të huaja, kulturave evropiane dhe diversitetit gjuhësor. Vendorsja dhe sistemimi i stendave duhet të jetë në mënyrë të rregullt dhe funksionale.
6. Çdo stendë duhet të ketë të afishuar emrin e shkollës pjesëmarrëse. Materialet prezantuese (postera) do të përgatiten në bashkëpunim me shkollat pjesëmarrëse dhe Autoritetin Kontraktor.
7. Operatori ekonomik duhet të sigurojë një moderator për drejtimin dhe mbarëvajtjen e aktivitetit, sipas këtyre specifikimeve:
  - Të zotërojë aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi në publik.
  - Të ketë aftësi organizative dhe menaxhimi të kohës, për të garantuar respektimin e axhendës.
  - Të jetë i aftë të koordinojë pjesëmarrësit, folësit dhe aktivitetet gjatë eventit.
  - Të përdorë gjuhë të qartë, profesionale dhe të përshtatshme për audiencën.
  - Të jetë i disponueshëm gjatë gjithë kohëzgjatjes së aktivitetit (nga fillimi deri në përfundim, 3 orë kohëzgjatje aktiviteti).
  - Të bashkëpunojë me stafin organizues për çdo nevojë logjistike apo ndryshim në program.

## **Dekorimi**

Operatori duhet të marrë përsipër dekorimin e plotë të hapësirës ku do të zhvillohet aktiviteti. Dekorimi duhet të reflektojë tematikën evropiane dhe shumëgjuhësore, si dhe frymën rinore dhe edukative të aktivitetit. Elementët minimalë të dekorit përfshijnë flamuj të vendeve të Bashkimit Evropian, elemente vizuale me fjalë dhe shprehje në gjuhë të ndryshme, postera informues mbi gjuhët dhe kulturat evropiane. Dekori duhet të jetë estetik, funksional, i sigurt për pjesëmarrësit dhe i përshtatshëm për ambiente të jashtme. Operatori është përgjegjës për montimin dhe çmontimin e plotë të dekorit.

## **Printime**

Poster (100 cm x 100 cm) për çdo shkollë pjesëmarrëse në aktivitetet. Përfshihet dizenjimi, printimi i posterave dhe vendosja e tyre në panair. Posteri duhet të realizohet në material karton me trashësi 3 mm, me sipërfaqe mat, duke siguruar printim cilësor me rezolucion të lartë. Vendosja e posterave duhet të bëhet duke përdorur kapëse, në mënyrë që të garantohet qëndrueshmëria gjatë gjithë aktivitetit.

## **B Dita e Tokës dhe mbrojtjes së biodiversitetit**

- ✓ Operatori duhet të sigurojë **transportin për të rinjtë vullnetarë** gjatë aktivitetit për Ditën e Tokës, me itinerar Shkodër – Velipojë - Shkodër, duke garantuar pjesëmarrjen e të 50 të rinjve.
- ✓ Operatori duhet të organizojë **aktivitetin sensibilizues për pastrimin e zonave turistike**, duke siguruar materialet e nevojshme si qese plehrash 70 L dhe doreza llastiku për 50 të rinjë.
- ✓ Gjithashtu operatori ekonomik duhet të marrë përsipër organizimin e një puntorie dedikuar fëmijëve si mbjellje lulesh/fidanë. Për këtë puntori do të sigurohet edhe baza materiale për të paktën 40 fëmijë, si më poshtë vijon:
- ✓ Për mbjellje lulesh/fidanë operatori duhet të sigurojë vazo të vogla lulesh për fëmijë, lule të ndryshme, fara lulesh dhe fidanësh të ndryshme (30 paketa), gota me material letre për farat e luleve dhe kubikë fidanësh (250 copë), dhe për lule (i përpunuar) (40 kg), vegla dore për kopshtari, karroca të vogla dore, etj.

## **C. Shkolla Pranverore Evropiane**

1. Operatori duhet të marrë përsipër transportin gjatë periudhës së Shkollës Pranverore Evropiane për 40 të rinj në itinerarin Shkodër- Ura e Mesit- Kalaja e Drishtit.
2. Operatori duhet të sigurojë transportin për aktivitetin sensibilizues për pastrimin e zonës së Velipojës me itinerar Shkodër-Velipojë që do të zhvillohet në kuadër të Ditës së Tokës.
3. Operatori ekonomik duhet të sigurojë materialet për Shkollën Pranverore Evropiane si më poshtë:
  - Të sigurojë 40 (dyzet) spila me logo të stampuar “logo aktivitetesh”, me diametër 0.55 mm.
  - Të sigurojë 40 (dyzet) rripa dore promociionale prej materiali plastik, me logo të stampuar dhe me mbishkrim të dedikuar sipas aktiviteteve.
4. Operatori ekonomik duhet të marrë përsipër printimin e 2 flamujve me mekanizëm me logon e Bashkisë Shkodër dhe aktivitetit. Lartësia e flamurit pa mbajtëse duhet të jetë 300 cm me gjërësi dhe 75 cm gjatësi.
5. Operatori duhet të marrë përsipër përfshirjen e tre specialistëve të fushës për çështjet e integritimit evropian që do referojnë nga dy orë në ditë të ndryshme secili gjatë ditëve të Shkollës Pranverore Evropiane.
6. Operatori ekonomik duhet të sigurojë shërbimin e kateringut për 40 persona gjatë ditëve të Shkollës Pranverore Evropiane sipas specifikimeve të parashikuara, si më poshtë vijon:

- **Të ëmblla;** Shporta me krem pastiçerie e fruta, kek dhe biskota të ndryshme.
- **Pije:** Ujë natyral, kafe
- Operatori merr përsipër cilësinë dhe sigurinë e ushqimit dhe pijes.
- Operatori merr përsipër transportin dhe shërbimin në vendin ku do të organizohet aktiviteti brenda qytetit të Shkodrës si dhe stafin shërbyes, një person staf shërbyes.
- Operatori mer përsipër të sigurojë pjata, gota, pirunj, tavolina, mbulesa, peceta për aktivitetin etj.
- Shërbimi katering do të organizohet në vendin ku do të zhvillohet aktiviteti do të përcaktohet nga autoriteti kontraktor brenda qytetit të Shkodrës.
- Shërbimi duhet të ofrohet për çdo rast në orën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor.